



**REPUBLIKA E KOSOVËS /
REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO**

C.nr.231/10

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN gjyqtarja Shpresa Emra në çështjen juridike të paditëseve D. A. , V. H. dhe K. Q. për vete dhe si e autorizuar e D. A. , të gjitha nga Prizreni, kundër të paditurit K. K., nga Prizreni, të cilin e përfaqëson avokati B. N. nga Prizreni, për vërtetim të pronësisë , në shqyrtimin kryesor të mbajtur me dt.06.06.2013 mori kete:

A K T G J Y K I M

- I. **APROVOHET** kërkespacia e paditëseve në tërësi si e bazuar
- II. **VERTETOHET** se paditëset V. H. , lindur K., D. A. , lindur K. dhe K. Q., lindur K. janë bashkëpronare në bazë trashigimisë nga babai i tyre A. K., me nga 1/3 pjesë ideale të palujtshmërisë me kulturë shtëpi me oborr e cila gjendet në Prizren rr. I. L. nr... e cila është e evidencuar si parc.kat.nr.2668/2 në sipërfaqe prej 3,60ari sipas list.pos.nr.8889 ZK Prizren, gjë që I padituri K. K. duhet të pranojë dhe të lejojë që palujtshmëria të rregjistrohet në emër të paditëseve në Drejtori për kadastër në Prizren të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga plëtuqishmëria e aktgjykimit nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm .
- III. **OBLIGOHET** i padituri që të paguaj shpenzimet procedurale.

A r s y e t i m

Pretendimet e palëve

Paditëset me padi kanë cekur se të njejtat janë trashigimtare ligjore të babait të tyre A. K. dhe me aktvendim të trashigimisë O.br.21/89 të dt. 20.02.1989 janë udhëzuar në kontest civil për realizimin të pronësisë në trashigimi të babait të tyre. Fillimisht si paditëse janë paraqitur paditëses D. A., V. H. dhe nëna e tyre M. K. kurse si të paditur janë paraqitur K. Q. dhe K. K. Në rigjykim në procesverbal me dt. 22.04.2013 është precizuar padia në kuptimin subjektiv dhe si paditëse tani janë paraqitur V. H., D. A. dhe K. Q., kurse si i paditur K. K. Gjithashtu, me precizim dhe në fjalën e fundit paditëset kanë kërkuar që gjykata ta aprovojë kërkesëpadinë dhe të shpallen si trashigimtare me nga 1/3 pjesë ideale të trashëgimisë së trashëgimlënësit A. K. dhe atë të shtëpisë e cila gjendet në Prizren e cila ka qenë prone e babait të tyre duke shtuar se vëllau i tyre K. K. i paditur në këtë rast është kompensuar nga pasuria e babait të tyre me një pjesë të palujtshmërisë ku ka ndërtuar shtëpinë të cilën i ka dhuruar babai deri sa ka qenë në jetë dhe në këtë drejtim atij nuk i takon pjesa nga shtëpia kontestuese. I kanë kërkuar shpenzimet sipas vleësimit të gjykatës.

I autorizuari i të paditurit në shqyrtime të mbajtura dhe në fjalën e tij të fundit ka deklaruar se konsideron se kërkesëpacia e paditëseve është e pabazuar nga se i padituri K. K. është trashigimtar ligjor i

rendit të pare të babait të tij A. K. nga Prizreni. Pretendimet se kinse I ka plotësuar pjesën e trashëgimisë në procedurën administrative me rastin e lejimit të truallit për ndërtim të shtëpisë nuk qëndron nga se trualli si sipërfaqe edhe në kohën e lejimit të ndërtimit të shtëpisë nuk ka figuruar si prone e trashigimlënësit , por ka qenë prone shoqërore dhe se procedura e ndarjes së truallit ka qenë e rregulluar me ligj dhe e nënshkruar bazuar në dispozita ligjore , ashtu që pjes e cila është dhënë si truall të paditurit është dhënë në bazë të vendimit kompetent administrative të personit juridik I cili në fakt ka qenë pronar i sipërfaqes së caktuar. Nga shkresa të lëndës ku pretendohet se I padituri ka marrë pjesën e tij të trashëgimisë, në asnjë vend nuk figuron që ekziston qfarëdo marrëveshje apo indikacioni që I njehti me fitimin e të drejtës së ndërtimit në prone, do të jetë I plotësuar me kërkesat e tia trashëgimore. Pra e drejta e trashëgimisë është e drejtë ligjore dhe nga e njehta askush nuk mund të përjashtohet, andaj propozoj që kërkesëpapia lidhur me përjashtimin e K. K. nga e drejta e trashëgimisë të refuzohet, ndërsa gjykata ta vërteton të drejtën e trashëgimisë të trashëgimlënësit A. K. në të gjithë trashëgimtarët e rendit të pare ligjorë, paditëset dhe I padituri me nga ¼ pjesë të paluajtshmërisë ideale. I ka kërkuar shpenzimet dhe atë për çdo shqyrtim të mbajtur me nga 136 €.

Vlerësimi i provave

Në procedurë të provave gjykata ka administruar këto prova: ka bërë leximin e kontratës mbi shtiblerjen e paluajtshmërisë Leg.nr.../55, të dates 12.11.1955; ka bërë shiqimin në certifikatën e Komunës së Prizrenit – zyra komunale e kadastrit të dates 13.02.2007; ka lexuar aktvendimin e Komunës së Prizrenit – drejtoria për çështje pronëso- juridike me numër 03/3-463-09, të dates 18.02.1982; ka lexuar procesverbalin mbi dëgjimin e palëve përpiluar në zyrën e shërbimit pronëso- juridike të Komunës së Prizrenit me date 21.01.1982; ka lexuar procesverbalin nga shqyrtimi kryesor i dates 19.07.1990; ka lexuar ekspertizën e ekspertës së gjeodezisë L. R. më date 02.07.2009 dhe ka lexuar aktvendimin e trashëgimisë T.nr.21/89, të dates 20.02.1989.

Me leximin e këtyre provave dhe në kuptim të nenit 8 të LPK gjeti se kërkesëpapia e paditëseve është e **bazuar**

Me leximin e kontratës mbi shtiblerjen e paluajtshmërisë Leg.nr.1069/55, të dates 12.11.1955, gjykata ka vërtetuar se e njehta është lidhur në zyrën e këshillit popullor të Komunës së Prizrenit si shitës në një rën anë, të cilin e përfaqëson A. D. – kryetar dhe blerësit A. K. – nëpunës nga Prizreni. Lëndë e kontratës ka qenë shitblerja e shtëpisë në rrugën B. V. në Prizren. Është përcaktuar vlera e shitblerjes, e cila do të paguhet në kohëzgjatje prej 30 vite me këste.

Me shiqimin në certifikatën e Komunës së Prizrenit – zyra komunale e kadastrit të dates 13.02.2007, gjykata ka vërtetuar se ngastra kadastrale nr.2668, në vendin e quajtur ish B. V., tani I. L., me kulture shtëpi, me sipërfaqe prej 0.01,56 ha, oborr në sipërfaqe prej 0.05,00 ha si dhe pemishte në sipërfaqe prej 0.03,51 ha në sipërfaqe të përgjithshme prej 0.10,07 ha, e evidentuar sipas listës poseduese nr.20, ZK Prizren, ka qenë e evidentuar në emër të B. G. nga Prizreni. Në vitin 1982 bëhet ndarja e parcelës në atë mënyrë të pronarës së mëparshme i mbetet parcela nr.2668/1, ndërsa ngastra kadastrale nr.2668/2 kalon në emër të A. K., në bazë të kontratës mbi shitblerjen Leg.nr.../55, të dates 12.11.1955. Po të njejtin vit, parcela kadastrale 2668/2 ndahet në dy pjesë ku me këtë numër mbetet në emër të A. K., sipas listës poseduese nr.8889 ZK Prizren, ndërsa parcela kadastrale nr.2668/3 kalon në emër të K. K., sipas listës poseduese nr.8939 ZK Prizren.

Me leximin e aktvendimit të Komunës së Prizrenit – drejtoria për çështje pronëso- juridike me numër 03/3-463-09, të dates 18.02.1982, gjykata ka vërtetuar se me këtë aktvendim bëhet bartja e të drejtës së shfrytëzimit në paluajtshmëri të nacionalizuar parcela nr.2668/2, në sipërfaqe prej 200m2, pa kompenzim në emër të K. K. nga Prizreni.

Me leximin e procesverbalit mbi dëgjimin e palëve përpiluar në zyrën e shërbimit pronëso- juridike të Komunës së Prizrenit me date 21.01.1982, gjykata vërtetoi se me këtë date është përpiluar procesverbali në çështjen juridike të bartjes të drejtës së shfrytëzimit nga babai në të birin, respektivisht A. K., ka dhënë deklaratë me të cilën ka bartur të drejtën e shfrytëzimit në parcelën e tij kadastrale nr 2668/2, në sipërfaqe prej 200 m2 në të birin K. K. Ka cekur se këtë paluajtshmëri ia fal të birit të tij. Procesverbali është nënshkruar nga A. K., personi zyrtar S. N. dhe dëshmitari E. M.

Me leximin e procesverbalit nga shqyrtimi kryesor i dates 19.07.1990, gjykata ka vërtetuar se në këtë shqyrtim janë administruar provat dhe është dëgjuar M. K. ish nga Prizreni – bashkëshortja e A. K.

Me leximin e ekspertizës së ekspertës së gjeodezisë L. R. më date 02.07.2009, gjykata ka vërtetuar se sipas evidences me të cilën sot disponon drejtoria për gjeodezi dhe kadastrë në Prizren, parcela kadastrale nr.2668/2, në sipërfaqe prej 3.60 ari evidentohet në emër të A. Sh. K. sipas fletës poseduese nr.8889 ZK Prizren, kurse parcela kadastrale nr.2668/3 në sipërfaqe prej 2.00 ari evidentohet në emër të K. A. K. nga Prizreni sipas fletës poseduese nr.8939 ZK Prizren që nga viti 1982.

Me leximin e aktvendimit të trashëgimisë T.nr.21/89, të dates 20.02.1989, trashëgimtarët M., D., V. K. si dhe K. Q., e lindur K., janë udhëzuar në kontest civil kundër K. K. nga Prizreni lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë në paluajtshmërinë e evidentuar si parcela kadastrale nr.2668/2 nga lista poseduese nr.8889 ZK Prizren si dhe në pasurinë e luajtshme të trashëgimlënësit A. K. nga Prizreni.

Vlerësimi juridik

Në rastin konkret gjykata pas administrimit të provave të parashtruara nga paditësi dhe vlerësimin e tyre veç e veç dhe bashkërisht ka vërtetuar gjendjen faktike si vijon nuk është kontestuese se paditëset dhe I padituri janë fëmijë të paraardhësit të përbashkët të tyre babit A. K. ish nga Prizreni. Gjithashtu nuk është kontestuese se babai I tyre është pronar I paluajtshmërisë kontestuese shtëpisë me oborr në Prizren. Fakti kontestues në këtë rast është se ai takon e drejta e trashëgimisë të paditurit në këtë shtëpi si trashëgimtarë ligjor.

Nga prova të adminstruar gjykata vërtetoi se trashëgimlënësi , babai i palëve ndërgjygjëse në procedurën administravtive para organeve zyrtare në Komunën e Prizrenit ka dhuruar të birit të tij këtu të paditurit, një pjesë të paluajtshmërisë nga paluajtshmëria e cila i ka takuar atij në sipërfaqe prej 200m2 në të cilën i padituri ka ndërtuar shtëpinë që në vitin 1982. Këtë fakt nuk e mohojnë asnjëra palë ndërgjygjëse duke shtuar se i padituri që nga ajo kohë jeton me familjen e tij të ngushtë në këtë shtëpi.

Me vet faktin se të paditurit i është dhuruar paluajtshmëria në sipërfaqe prej 200m2 kurse paluajtshmëria e cila ke mbetur në pronësi të trashëgimlënësit ka qenë në sipërfaqe prej 360m2 shihet se i padituri e ka pranuar pjesën e tij të trashëgimisë e cila dhuratë nuk është e zakonshme, por dhuratë me vlerë të caktuar. Bazuar në Ligjin mbi trashëgiminë i vitit 1974 e cila ka qenë në fuqi kur është parashtruar padia neni 40 i këtij ligji i cili cekë **“se çdo trashëgimtar i ligjor i llogaritet në pjesën trashëgimore çdo**

gjë që ka marrë dhurim nga trashëgimlënësi në çfarëdo mënyre. Dhurimi nuk llogaritet në qoftë se trashëgimlënësi ka deklaruar në kohën e dhurimit ose më vonë, ose në testament, se dhurimi nuk do të llogaritet në pjesën trashëgimore, ose nga rrethanat mund të konkludohet se ky ka qenë vullneti i trashëgimlënësit. “ Nga kjo rjedhë se i padituri ka pranuar pjesën e tij trashigimore në formë dhurate vlera e së cilës palujtshmëri është e përafërt me vlerën e tërë palujtshmërisë e cila do të duhetj të ndahej në mes të trashigimtarëve të tjerë në tri pjesë. Nëse do të ndahej palujtshmëria në pjesë të domosdoshme atëherë pjesa e palujtshmërisë së të paditurit do të tejkalonte vlerën e pjesës së domosdoshme të cilën do të përfitonin trashigimtarët tjerë. Me deklaratën e tij të dhënë në zyrën e Komunës së Prizrenit, babai i palëve ndërgjygjëse nuk është deklaruar shprehimisht që nuk do të llogaritet dhurimi në dobi të paditurit si e parasheh ligji i lartëcekur, andaj gjykata konstatoi se kjo deklaratë dhe vet pranimi i palujtshmërisë e kanë bindur gjykatën se i padituri e ka pranuar pjesën e tij të trashigimisë që në jetë të trashigimlënësit dhe nga vet ai. Andaj gjykata ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit me aprovim të kërkesëpadsisë së paditëseve të cilat janë shpallur si bashkëpronare në palujtshmëri kontestuese në bazë të trashigimisë

Vendimi mbi shpenzimet procedurale është marrë në bazë të nenit 452.1 LPK pasi që pala e cila e humb kontestin obligohet ti kompenzojë shpenzimet pales fituese.

GJYKATA THEMELORE NE PRIZREN
Cnr.231/10 me dt.06.06.2013

Gjyqtarja
Shpresa Emra

KËSHILLA JURIDIKE - Pala a pakënaqur ka të drejtë ankese në afat prej 15 ditëve Gjykatës së Apelit në Prishtinë . Ankesa i dorëzohet kësaj gjykate.